

## **HRMV TRANSPORT SHA - SHKUP**

**Numër: 1693/1**

**Data: 06.08.2020**

**SH K U P**

Në përputhje me nenin 26 paragrafi 1, pikat 4 dhe 8 të Statutit të HRMV Transport SHA – Shkup, në bazë të Protokollit për masa preventive të miratuara nga Qeveria e RMV (Gazeta zyrtare numër 147 i datës 03.06.2020) dhe Propozimin e sjellë nga Komisioni për mbrojtje nga COVID – 19, i formuar me Vendimin numër 659/1 i datës 11.03.2020 solli

### **PROTOKOLL**

**për marrjen e masave adekuate dhe aktivitete për parandalimi të përhapjes së sëmundjes – COVID – 19 gjatë mbajtjes së provimit profesional**

**1. Masa dhe aktivitete para dhënies së provimit:**

- 1.1. Dhënia e provimit profesional do të mbahet me pjesëmarrje fizike në sallën e shkollës në NJP- tërheqje, pas publikimit të orarit të mëhershëm dhe në kohë nga Qendra e trajnimit në tabelën e publikimeve dhe web-faqen e HRMV Transport SHA – Shkup. Gjatë përpilimit të orarit për dhënien e provimit, Qendra për trajnimin detyrimisht do të kujdeset për numrin e personave dhe mundësitë hapësirore të sallës ku do të mbahet provimi me qëllim të sigurojë mbrojtje të plotë të punësuarve nga COVID – 19;
- 1.2. Udhëheqësi i Qendrës për trajnim detyrohet të përcaktoj persona zyrtar të cilët detyrimisht më parë kryejnë dezinfektim të gjithë objektit ku gjindet salla e shkollës në NJP- tërheqje;
- 1.3. Udhëheqësi i Qendrës për trajnim detyrohet të përcaktojë persona zyrtar të cilët detyrimisht në hyrje të hapësirës ku do të mbahet provimi të vendosin materiale edukative dhe informuese për respektimin e masave parandaluese mbrojtëse;
- 1.4. Udhëheqësi i Qendrës për trajnim detyrohet të përcaktojë persona zyrtar të cilët detyrimisht në hyrje dhe në hapësirat ku do të mbahet provimi të sigurohet mjet për dezinfektimin e duarve dhe këpucëve, me qëllim të sigurohet respektimi i masave të përgjithshme për nivel më të lartë të higjienës personale dhe higjienës të përgjithshme;
- 1.5. Udhëheqësi i Qendrës për trajnim detyrohet të përcaktojë persona zyrtar të cilët nuk do të lejojnë hyrje pa maskë mbrojtëse dhe dezinfektim të detyrueshëm të duarve ( me mjet dezinfektues) dhe këpucët të dezinfektohen në vend special të ngjitur në dysheme me mjet dezinfektues në hyrje të hapësirës ku do të mbahet provimi;
- 1.6. Udhëheqësi i Qendrës për trajnim detyrohet të përcaktojë persona zyrtar të cilët detyrimisht në hapësirën e mbajtjes së provimit të sigurojë kosh të plehra me kapak;
- 1.7. Udhëheqësi i Qendrës për trajnim detyrohet që me gojë t'i paralajmërojë personat të cilët kanë simptome respiratore (temperaturë, kollë, vështirësi në frymarje) t'i paraqesin këto simptome dhe për të shtyhet mbajtja e provimit deri në momentin kur do të largohen të gjitha dyshimet rreth gjendjes së tyre shëndetësore;
- 1.8. Udhëheqësi i Qendrës për trajnim detyrohet të përcaktojë persona zyrtar të cilët detyrimisht do të organizuar rendin gjatë hyrjes në hapësirën ku do të mbahet provimi, të shënojnë vendet ku është e lejuar të ulet me respektim të distancës fizike d.m.th. mes tavolinës/karrikeve të

përcaktuara për atë qëllim, përkatësisht duhet të ketë distancë prej 2 metre mes pjesëmarrësve në hapësirë.

**2. Masa dhe aktivitete në kohën e dhënies së provimit dhe pas mbarimit të provimit:**

- 2.1. Pjesëmarrësit detyrimisht dhe në kontinuitet të mbajnë maskë mbrojtëse në fytyrë dhe vetëm në momentin e identifikimit dhe me kërkesë të Komisionit kanë obligim për shkurtë kohë të ulë maskën;
  - 2.2. Anëtarët e Komisionit të cilët e zbatojnë provimin detyrimisht të mbajnë maskë mbrojtëse në fytyrë dhe doreza, të cilat duhet të sigurohen nga Shoqëria;
  - 2.3. Midis secilit termin, përkatësisht orarit të dhënies së provimit detyrimisht të ketë pauzë me kohëzgjatje prej 30 minuta. Personat e detyruar të Udhëheqësit të Qendrës për trajnim janë të detyruar gjatë kohës së pauzës të kontrollojnë dhe dezinfektojnë më shpesh hapësirën;
  - 2.4. Gjatë kohës së pauzave ndalohet grupimi i pjesëmarrësve;
  - 2.5. Udhëheqësi i Qendrës për trajnim detyrohet të përcaktoj persona zyrtar të cilët detyrimisht pas mbarimit të provimit, të pastrojnë dhe dezinfektojnë me mjete dezinfektuese gjithë hapësirën e shkollës;
  - 2.6. Udhëheqësi i Qendrës për trajnim detyrohet të përcaktoj persona zyrtar të cilët detyrimisht do të kryejnë mirëmbajtje të rregullt dhe të shpeshtë të higjienës së koridoreve dhe tualeteve me mjete dezinfektuese.
- 3. Rregulla të përgjithshme për zbatimin e këtyre masave:**
- 3.1. Ky protokoll paraqet detyrim të punës për Udhëheqësin e Qendrës për trajnim dhe për të gjithë personat të cilët do të marrin pjesë në provimin profesional.
  - 3.2. Udhëheqësi i Qendrës për trajnim ka të drejtë dhe obligim në rast se ka nevojë të kërkojë angazhim të numrit plotësues të personave zyrtar dhe nga Komisioni për mbrojtje nga COVID-19, Drejtori për çështje juridike, burime njerëzore dhe funksione kooperative dhe drejtore tjerë.
  - 3.3. Udhëheqësi i Qendrës për trajnim në kordinim me Komisionin për mbrojtje të COVID – 19 pranë HRMV Transport SHA – Shkup mund të kryejë modifikim në disa rregulla të përcaktuara në rast kur e imponon rasti dhe nevoja për parandalim shtesë të përhapjes së sëmundjes.
  - 3.4. Mosrespektimi i këtij protokoll paraqet shkelje të rëndë të rendit dhe disiplinës së punës dhe bazë për ngritjen e procedurës disiplinore, dhe gjithashtu dhe bazë për largimin e personit nga objekti i cili nuk e respekton këtë protokoll.



Produzuar:

Komisioni për mbrojtje nga COVID-19

Nevena Dugičevska

Larçe Gjaniq

Juliana Vengiq

Përkthues:

Drita Abdulla